

33858

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË  
NR 33858 VENDIMIT

**V E N D I M**  
**PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK**

Sot me date 28.07.2005 unë gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Regleta Panajoti pasi shqyrtova kërkesën e paraqitur nga administratori i shoqërisë Ferdinant Aligjoni, për rregjistrimin person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „FOKUS TV ”sh.p.k

**K O N S T A T O V A:**

Se kerkuesi me cilësinë e administratorit të shoqërisë, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me kërkesën për rregjistrimin person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar " FOKUS TV "sh.p.k, me:

**Ortakë** : Ferdinant Aligjoni dhe Agron Brataj

**Seli** : Vlore, Lagja Uji i Ftohte, vile private prane Hotel EUROPA.

**Kohezgjatje** mbi 10 vjet

**Kapital themeltar** 100.000 lek i ndarë ky midis dy ortakëve :

Ortaku Ferdinant Aligjoni zoteron 66 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 66 pjesë, me vlerë totale prej 66 000 lekë (gjashtedhjetegjashtëmijë).

Ortaku Agron Brataj zotëron 34 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 34 pjesë, me vlerë totale prej 34 000 lekë (tridhjetekatermije)

Administrator : Ferdinant Aligjoni

**Objekt** të veprimtarisë:

Veprimtari Radio televizive lokale, bazuar në legjislacionin në fuqi " Per Radion dhe televizionin Publik dhe Privat në Republikën e Shqipërisë, prodhimi, transmetimi dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zerit, figures, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valeve elektromagnetike, kablove, perseritesve, sateliteve apo me çdo mjet tjetër në përputhje me formën e shoqërisë (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar).

Sa më sipër çmoj se dokumentacioni i paraqitur është i plotë, kërkesa e paraqitur është e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar

**PËR KËTO ARËSYE**

Në bazë të ligjit 7638 date 19.11.1992 „ Për shoqëritë tregëtare „ dhe ligjit 7667 datë 28.1.1993 „ Për Rregjistrin Tregëtar “

## V E N D O S A .:

- Pranimin e kërkesës
- Regjistrimin si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar " " FOKUS TV "sh.p.k, me:

**Ortakë :** Ferdinand Aligjoni dhe Agron Brataj

**Seli :** Vlore, Lagjja Uji i Ftohte, vile private prane Hotel EUROPA.

**Kohezgjatje** mbi 10 vjet

**Kapital themeltar** 100.000 lek i ndarë ky midis dy ortakëve :

Ortaku **Ferdinant Aligjoni** zoteron 66 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 66 pjesë, me vlere totale prej 66 000 lekë (gjashtedhjetegjashtëmijë).

Ortaku **Agron Brataj** zotëron 34 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 34 pjesë, me vlerë totale prej 34 000 lekë (tridhjetekatermije)


**Administrator :** Ferdinand Aligjoni

**Objekt te veprimtarisë:**

Veprimtari Radio televizive lokale, bazuar ne legjislacionin ne fuqi " Per Radion dhe televizionin Publik dhe Privat ne Republiken e Shqiperise, prodhimi, transmetimi dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter ne perputhje me formen e shoqcrise (shoqeri me pergjegjesi te kufizuar).

Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit

Gjyqtare  
Regleta Panajoti



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE  
ZYRA E RREGJISTRIT TREGETAR

URDHER RREGJISTRIMI

KOLONA I	Numri i Rregjistrimit tregëtar <b>33858</b>
KOLONA II	B. A. Emri i shoqërisë : " FOKUS TV "sh.p.k, C. Vlore, Lagjja Uji i Ftohte, vile private pranë Hotel EUROPA D. Objekti: Veprimtari Radio televizive lokale, bazuar në legjislativën në fuqi " Per Radion dhe televizionin Publik dhe Privat në Republikën e Shqipërisë, prodhimi, transmetimi dhe ritransmetimi e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablove, perseritesve, sateliteve apo me çdo mënyrë tjetër në përputhje me formën e shoqërisë (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar). D. Kapitali : 100.000 lek
KOLONA III	A.ORTAKE Ferdinant Aligjoni dhe Agron Brataj B.ADMINISTRATORI Ferdinant Aligjoni, i biri i Selamit dhe Pashakos , datlindja 17.09.1959, banues në Vlore, mbajtes i pasaportës nr.Z 0289645
KOLONA IV	Kohezgjatja mbi 10 vjet
KOLONA V	Shënime mbi aktet e shoqërisë A.Data e nënshkrimit : 27/07/2005 B.Data e rregjistrimit: 28.07.2005 C.Statuti flete: 6 (gjashtë) D.Akti i themelimit flete : 3 (tre)

SHENIME

Kapitali themeltar depozituar pranë noteres Dhimitra Qarri dt 26.07.2005 nr 16 regi.

GJYQTARE  
Regleta Panajoti





## AKTI I THEMELIMIT TË

## SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### “FOKUS TV” SH.P.K

Sot në Tiranë më datë 25/07/2005, personat shtetas shqiptare:

**Ferdinant Aligjoni**, i biri i Selamit dhe Pashakos , datlindja 17.09.1959, banues në Vlore, mbajtes i pasaportes nr.Z 0289645, dhe

**Agron Brataj**, i biri i Ramadanit dhe Hanisese, 15.06.1972, datëlindja 15.06.1972, banues në Vlore, mbajtes i pashaportës nr. Z0762403.

Themelojnë shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “FOKUS TV” SH.P.K dhe hartojnë për këtë qëllim Aktin e Themelimit të shoqërisë me përmbajtje si vijon:

#### NENI 1

#### EMËRTIMI I SHOQËRISË

1.1 Emërtimi i shoqërisë është “FOKUS TV” SH.P.K

#### NENI 2

2.1 Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanërisht, por jo ekskluzivisht, me nenet 11 dhe 12 të ligjit 7491 datë 29.04.1991 ”Për dispozitat kryesore kushtetuese, në ligjin 7638 datë 19.11.1992 ” Për Shoqëritë Tregëtare “ dhe ligjin 7667 datë 28.1.1993 “ Për Rregjistrin Tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar për shoqëritë tregëtare”, aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së shoqërisë si dhe me dispozitat e Statutit të shoqërisë .

#### NENI 3

#### FORMA

3.1 Shoqëria “FOKUS TV” SH.P.K ,është “ Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar” sh.p.k

#### NENI 4

4.1 Selia e shoqërisë në Vlore, Lagjja Uji i Ftohte, vile private pranë Hotel EUROPA.

Ferdinant Aligjoni  
*[Signature]*

Agron Brataj  
*[Signature]*



## NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë : Veprimtari Radio televizive lokale, bazuar ne legjislacionin ne fuqi " per Radion dhe televizionin Publik dhe Privat ne Republikën e Shqipërise, prodhimi, transmetimi dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter ne perputhje me formen e shoqerise (shoqeri me pergjegjesi te kufizuar).

## NENI 6

6.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë mbi 10 vjet, dhe do të fillojë nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të gjykatës Tiranë me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos asambleja e ortakëve .

## NENI 7 TERRITORI

7.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, gjithashtu ajo mund të hapë, filiale, dege, ose përfaqësi në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, apo në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vëndeve përkatëse.

## NENI 8 KAPITALI DHE PJESËT

8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë ka vlerën 100 000 lekë (njëqindmijë) i cili ndahet në 100 pjesë secila me vlerë prej 1000 lekë.

8.2 Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të marrë prej Ortakëve. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e pjesëve të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.


8.2 Kapitali themeltar i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të marrë nga e Asamblesë së Ortakëve. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që ata përfaqësojnë.

## NENI 9 KONTRIBUTET

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë, zotërohet nga ortakët e shoqërisë Ferdinant Aligjoni e Agron Brataj si vijon:

Ferdinant Aligjoni  
*Ferdinant Aligjoni*

Agron Brataj  
*Agron Brataj*



9.2 Ortaku Ferdinand Aligjoni zotëron 66 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 66 pjesë, me vlerë totale prej 66 000 lekë (gjashtedhjetegjashtëmijë).

9.3 Ortaku Agron Brataj zotëron 34 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 34 pjesë, me vlerë totale prej 34 000 lekë (tridhjetekatermijë)

9.4 Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e dy ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

9.5 Për nevoja të punës dhe të ushtrimit të aktivitetit të saj shoqëria mund të çelë llogari në çdo bankë të njohur me ligj, qoftë kjo private ose shtetërore.

## NENI 10 ADMINISTRIMI

10.1 Shoqëria administrohet nga një ose me shumë administratorë të cilët janë persona fizik të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.

10.2 Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të ortakëve që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

10.3 Emërimi i administratorëve bëhet për një afat 3 ( tre) vjecar, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.

## NENI 11 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

11.1 Administratorëve iu njihet e drejta për të ushtruar të gjitha kompetencat për kryerjen e veprimeve të administrimit dhe të përfaqësimit në emër të shoqërisë, në interes të saj dhe nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e Shoqërisë, Principet e Biznesit dhe vendimet e Asamblesë së ortakëve të shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe statuti ia japin shprehimisht ortakëve.

## NENI 12 EMËRIMI I PARË I ADMINISTRATORËVE

Administrator i shoqërisë me krijimin e saj, për periudhën 3 vjecare emërohet **Ferdinant Aligjoni** i cili është edhe ortak të shoqërisë.

Akti i Themelimit u përpilua në gjuhën shqipe, në katër kopje origjinale, duke pasur të gjitha fuqitë ligjore të barabarta për tu administruar sipas ligjit.

## ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Ferdinant Aligjoni

Agron Brataj

Ferdinant Aligjoni

Agron Brataj



## STATUTI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “FOKUS TV” SH.P.K HYRJE

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “FOKUS TV” SH.P.K, është themeluar nga :  
**Ferdinant Aligjoni**, i biri i Selamit dhe Pashakos, datlindja 17.09.1959, banues ne Vlore, mbajtes i pasaportes nr.Z 0289645, dhe  
**Agron Brataj**, i biri i Ramadanit dhe Hanisese, 15.06.1972, datëlindja 15.06.1972, banues në Vlore, mbajtës i pasaportës nr. Z0762403.  
Themeluesit në përputhje me ligjin hartojnë edhe statutin e Shoqerise si më poshtë:

#### EMERTIMI I SHOQERISE

1.1 Emërtimi i shoqerisë është “FOKUS TV” SH.P.K

#### NENI 2

2.1 Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe vecanërisht, por jo ekskluzivisht, me nenet 11 dhe 12 te ligjit 7491 date 29.04.1991 ”Për dispozitat kryesore kushtetuese, ne ligjin 7638 date 19.11.1992 ”Per Shoqerite Tregëtare “ dhe ligjin 7667 date 28.1.1993 “Për Rregjistrin Tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar për shoqëritë tregëtare, aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së shoqërisë si dhe me dispozitat e Statutit të shoqërisë .

#### NENI 3 FORMA

3.1 Shoqëria “FOKUS TV” SH.P.K eshte “Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar” sh.p.k


#### NENI 4

4.1 Selia e shoqerisë është në Vlore, Lagjja Uji i Ftohte, vile private prane Hotel EUROPA.

#### NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Ferdinand Aligjoni  
*Ferdinand Aligjoni*

Agron Brataj  
*Agron Brataj*



Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :Veprimtari Radio televizive lokale, hazuar ne legjislacionin ne fuqi " Per Radion dhe televizionin Publik dhe Privat ne Republiken e Shqiperise, prodhimi, transmetimi dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjetër ne perputhje me formen e shoqerise (shoqeri me pergjegjesi te kufizuar).

NENI 6

6.1 Kohëzgjatja e shoqerisë do të jetë mbi 10 vjet dhe do të fillojë nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Gjykatës Së Shkallës së Parë Tiranë me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos asambleja e ortakëve .

NENI 7  
TERRITORI

7.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, gjithashtu ajo mund të hapë, filiale, degë, ose përfaqësi në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, apo në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vëndeve përkatëse.

NENI 8  
KAPITALI DHE PJESËT

8.3 Kapitali themeltar i shoqërisë ka vlerën 100 000 leke (nejqindmije)i cili ndahet ne 100 pjesë, sejcila me vlere prej 1000 leke.

8.2 Kapitali themeltar i shoqerisë mund të zmadhohet, me vendim të marë prej ¾ nga Asambleja e Ortakëve. Në rast zmadhimi te kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit te pjesëve te reja, ortakët kanë te drejtën e përparësise në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e pjesëve të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.

8.4 Kapitali themeltar i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të marrë nga ¾ e Asamblese së Ortakëve. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve te kapitalit që ata perfaqësojnë.

NENI 9  
KONTRIBUTET

9.1 Kapitali themeltar i shoqerisë zotërohet nga ortakët e shoqërisë Ferdinand Aligjoni eAgron Brataj si vijon:

9.2 Ortaku Ferdinand Aligjoni zotëron 66 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 66 pjesë, me vlere totale prej 66 000 lekë (gjashtedhjetegjashtëmijë).

Ferdinand Aligjoni  
Agron

Agron Brataj



9.3 Ortakur Agron Brataj zotëron 34 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 34 pjesë, me vlerë totale prej 34 000 lekë (tridhjetekatërmije)

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

9.5 Për nevoja të punës dhe të ushtrimit të aktivitetit të saj shoqëria mund të çelë llogari në çdo bankë të njohur me ligj, qofte kjo private ose shtetërore.

#### NENI 10 TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR

10.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Trashëgimtari, paraardhësi ose pasardhësi, bëhen ortakë, nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar vetëm pasi të jenë miratuar nga Asambleja e Ortakëve.

10.2 Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendim të marrë me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit themeltar.

10.3 Në rast kur njeri apo disa nga ortakët dëshirojnë të transferojnë pjesërisht apo plotësisht, pjesët që ata zotërojnë në kapitalin themeltar tek të tretët, më parë duhet që oferta për shitje të bëhet ortakëve të tjerë të shoqërisë, me të njëjtat kushte që do t'i bëhet të tretëve.

#### NENI 11

11.1 Ortakët përballojnë humbjet e shoqërisë vetëm deri në kufirin e vlerës që ata kanë kontribuar në kapitalin e saj themeltar,

11.2 Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron. Në ushtrimin e të drejtës së tij për të marrë pjesë në vendimet kolektive, cdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një ortak tjetër apo kur bashkëshorti ose një person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë autorizuar me prokurë.

11.3 Mbledhja e Asamblesë mund të kërkohet nga një ose disa ortakë që zotërojnë mbi  $\frac{1}{10}$  e pjesëve të kapitalit themeltar, nga administratorët, nga ekspertet kontabel të autorizuar, po qe se ka të tilla ose nga likujduesit. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë bëhet nga administratorët.

11.4 Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e Asamblesë mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme. Asambleja e Zakonshme vendos për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndatja e fitimeve etj.

11.5 Asambleja e zakonshme në mbledhjen e parë mund të marrë vendime të vlefshme në qoftë se janë të pranishëm ose të përfaqësuar një numër ortakësh që zotërojnë mbi  $\frac{1}{2}$  e pjesëve të kapitalit themeltar dhe vendimet merren nga ortakët që përfaqësojnë mbi  $\frac{1}{2}$  e pjesëve të kapitalit. Në qoftë se mbledhja e parë e Asamblesë së zakonshme nuk realizohet thirrret mbledhja e dytë e cila mund të marrë vendime të

Ferdinand Aliqani  
Aliqani

Agron Brataj  
Brataj

SHOQËRISË  
E  
KALIFORNIË

vlefshme, zmadhimin e shumices së ortakëve që kanë qënë të pranishëm pavarësisht nga numri i pjesëve të kapitalit themeltar që ato zotërojnë.

11.6 Asambleja e jashtëzakonshme vendos për çështje të tilla si ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, transferimin tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera etj si dhe cdo çështje tjetër që parashikohet në ligj.

## NENI 12 ADMINISTRIMI

12.1 Shoqëria administrohet nga nje ose disa administratorë të cilët janë persona fizik të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.

12.2 Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të ortakëve që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

12.3 Emërimi i administratorëve bëhet për një afat 3 ( tre) vjecar, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.

## NENI 13 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

13.1 Administratorëve u njihet e drejta për të ushtruar të gjitha kompetencat për kryerjen e veprimeve të administrimit dhe të përfaqësimit në emër të shoqërisë, në interes të saj dhe nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e Shoqërisë, Principet e Biznesit dhe vendimet e Asamblesë së ortakëve të shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe statuti ia japin shprehimisht ortakëve.

## NENI 14 EMËRIMI I PARË I ADMINISTRATORËVE

14.1 Administrator me krijimin e shoqërisë per periudhën 3 vjecare emërohet ortakun Ferdinant Aligjoni,

## NENI 15 EKSPERTË KONTABËL TË AUTORIZUAR

15.1 Në rast nevoje si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga ortakët që përfaqësojnë ½ e kapitalit themeltar.

15.2 Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vednoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

## NENI 16 VITI FINANCIAR

Ferdinant Aligjoni

Agon Buzotaj



6.1 Cdo vit financiar fillon nga 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

## NENI 17 LLOGARITË VJETORE

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja me vendimin e ortakëve që zotërojnë mbi  $\frac{1}{2}$  e pjesëve të kapitalit themeltar.

17.2 Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore bëhet brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar

## NENI 18 DIVIDENTET

18.1 Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja e ortakëve përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendeve mbi fitimin proporcionalisht me përqindjen e pjesmarrjes së gjithsecilit në shoqëri. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcione me pjesët e kapitalit themeltar, përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm (5 % e fitimit të cdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën  $\frac{1}{10}$  e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

## NENI 19 PRISHJA

19.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të përcaktuar, kur kjo vendoset nga ortakët si dhe kur janë arësytet e parashikuara në ligj. Shoqëria nuk priset kur njëri prej ortakëve falimenton, bëhet i paaftë ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjerë që kanë mbetur si dhe me trashëgimtarët e radhes së parë të ortakut që vdes, pasi ata të jenë miratuar më parë nga Asambleja e Ortakëve sipas shumicës së votave të përcaktuara në nenin (10.2) të Statutit.

## NENI 20 LIKUJDIMI

20.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimi që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asambleja emëron një likujdues, i cili i paraqet asaj raportin e likujdimi dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

20.2 Në fund të procesit të likujdimi Asambleja vendos me vendimin e ortakëve që zotërojnë të paktën e  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit themeltar, mbi bilancin përfundimtar e financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likujduesit dhe për mbylljen e procesit të likujdimi.

20.3 Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkatës, likujduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.

Ferdinand Aliçani

Agon Brostaj



## NENI 21

### SHNDËRIMI I SHOQËRISË

21.1 Shndërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri komandite mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të ortakëve .

## NENI 22

### MOSMARËVESHJET

22.1 Të gjitha mosmarëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit midis ortakëve, ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

## NENI 23

Për çështje që nuk janë parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi për Shoqëritë Tregëtare .  
Ky statut nënshkruhet nga dy themeluesit.

### THEMELUESIT E SHOQËRISË

“FOKUS TV” SH.P.K

Ferdinant Aligjoni

Agron Brataj

*Ferdinant Aligjoni*  
*Aligjoni*

*Agron Brataj*  
*Brataj*



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**  
**NR 429 REP NR 392 KOL**  
**Notere Dhimitra Qarri**  
**Adresa : Blv Gjergj Fishta pranë Gjykatës së**  
**Shkallës së Parë Tiranë tel 251 200 / 0692095571**

---

## VERTETIM


Ne qytetin e Tiranës sot më datën 27.07.2005 para meje noteres publike Dhimitra Qarri e rregjistruar pranë Dhomës se Noterisë Tiranë, me Zyre Noteriale në Tiranë në Bulevardin Gjergj Fishta, u paraqitën personalisht:

**Ferdinant Aligjoni**, i biri i Selamit dhe Pashakos , datlindja 17.09.1959, banues ne Vlore, mbajtes i pasaportes nr.Z 0289645, dhe

**Agron Brataj**, i biri i Ramadanit dhe Hanisese, 15.06.1972, datëlindja 15.06.1972, banues në Vlore, mbajtës i pashaportës nr. Z0762403.madhorë me zotësi te plotë juridike për të vepruar, te cilët me vullnet te lirë e të plotë deklaruan se sa më sipër është Statuti i shoqerisë “FOKUS TV” SH.P.K

I përpiluar prej tyre jashtë kesaj Zyre Noteriale, nënshkruajnë në praninë time dhe unë noterja e vërtetoj nënshkrimin ne bazë te ligjit „Per Noterinë“ ne fuqi pasi e gjej përmbajtjen e akteve në përputhje me ligjin 7638 datë 19.11 1992”Për Shoqeritë Tregëtare “.

PULLE TAKSE



NOTERE

DHIMITRA QARRI



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR 4289 REP NR 39 / KOL

Notere Dhimitra Qarri

Adresa : Blv Gjergj Fishta pranë Gjykatës së  
Shkallës së Parë Tiranë tel 251 200 / 0692095571

## VERTETIM

Ne qytetin e Tiranës sot më datën 27.07.2005 para meje noteres publike Dhimitra Qarri e regjistruar pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me Zyrë Noteriale në Tiranë në Bulevardin Gjergj Fishta, u paraqitën personalisht:

**Ferdinant Aligjoni**, i biri i Selamit dhe Pashakos , datlindja 17.09.1959, banues ne Vlore, mbajtes i pasaportes nr.Z 0289645, dhe

**Agron Brataj**, i biri i Ramadanit dhe Hanisese, 15.06.1972, datëlindja 15.06.1972, banues në Vlore, mbajtës i pasaportës nr. Z0762403.madhorë me zotësi te plotë juridike për të vepruar, te cilët me vullnet te lirë e të plotë deklaruan se sa më sipër është akti për themelimin e shoqerisë “FOKUS TV” SH.P.K

përpiluar prej tyre jashtë kesaj Zyre Noteriale, nënshkruajnë në praninë time dhe unë noterja e vërtetoj nënshkrimin ne bazë te ligjit „Per Noterinë“ ne fuqi pasi e gjej përmbajtjen e akteve në përputhje me ligjin 7638 datë 19.11 1992”Për Shoqeritë Tregëtare “.

NOTERE

DHIMITRA QARRI

PULLE TAKSE









Tirane me 26.07.2005

VERTETIM NOTERIAL

Ne Tirane sot me daten 26.07.2005 para meje noteres publike Dhimitra Qarri u paraqiten :

**Ferdinant Aligjoni**, i biri i Selamit dhe Pashakos , datlindja 17.09.1959, banues ne Vlore, mbajtes i pasaportes nr.Z 0289645, dhe

**Agron Brataj**, i biri i Ramadanit dhe Hanisese, 15.06.1972, datëlindja 15.06.1972, banues në Vlore, mbajtës i pashaportës nr. Z0762403.

ortake te shoqerise „FOKUS TV ” shpk ; te cilet depozituan per llogari te kesaj shoqerite, shumen prej 100 000 leke, konform nenit 40 ligjit 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite Tregtare” si kapital themeltar per shoqerine se mesiperme ne krijim e siper.



Notere  
Dhimitra Qarri

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Dhimitra Qarri', written over a circular stamp.